



Zyra Tiranë

**Objekti: NJOFTIM PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SE PERSONELIT VENDAS
PËR TU PUNËSUAR ME KONTRATË ME AFAT TË PACAKTUAR PRANË PIKËS
SË KORRESPONDENCËS ICE – AGJENCIA PRISHTINË**

Drejtori i Zyrës së ICE - Agjencia e Tiranës, nga e cila varet Pika e Korrespondencës (PdC) ICE së Prishtinës,
Dr. Francesca Mondello:

DUKE QENË SE

Dekreti ndërministror i dates 8 korrik 2022 n. 3612/2052 me të cilin është miratuar Statuti i ri i Agjencisë për promovimin dhe ndërkombëtarizimin e firmave italiane dhe në veçanti neni 12 pika 3 në të cilin citohet se Agjencia ICE vepron jashtë vendit përmes njësive të saj operative të vendosura në kuadër të Përfaqësive Diplomatike dhe konsullore;

DUKE QENË SE

autorizimi i Drejtorit të Përgjithshëm, prot. n. 0034606/24 date 21/03/24, vendos të fillojë një procedurë përzgjedhjeje për punësimin e me afat të pacaktuar të një Asistenti Analist Tregu (M1);

DUKE MARRË NË KONSIDERATË

nenin 14 paragrafi 4 të statutit të lartpërmendur, në të cilin citohet se përzgjedhja dhe marrëdhënia e punës e personelit të punësuar në vend për nevojat e njësive operative të Agjencisë ICE jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e nenit 14 pika 25 të ligjit themelues, edhe nëse ka nënshtetësi italiane, disiplinohet nga normat dhe rregullat lokale.

NJOFTON SE

është shpallur një procedurë e përzgjedhjes për punësimin e një figure me detyrë në fushën e marketingut si asistent analist tregu, me një periudhë prove prej 6 (gjashtë) muajsh, me një afat të pacaktuar. Vendi i punës do të jetë Pika e Korrespondencës ICE në Prishtinë. Paga bruto mujore do të jetë e barabartë me 860,00 Euro. Ju bëjmë me dije se ICE nuk njeh asnjë shpenzim për të mbërritur në Vendlin e punës që do të jetë pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë.

Procedura e përzgjedhjes do të zhvillohet në Prishtinë.

1. Kriteret, kualifikimet dhe eksperiencia për pranim

Mund të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes kandidatët që zotërojnë kriteret, kualifikimet dhe eksperiencat e kërkuara në datën e këtij njoftimi:

- Te kene mbushur moshën 18 vjeç;
- Jane ne posedim te nje Diplome trevjeçare (Bachelor) ose Diplomë e sistemit të vjetër ose Master specializim, e preferueshme në Ekonomi, Drejtësi, Shkenca Politike;
- Përvoja te mëparshme pune në shoqëri apo institucione italiane, vendase apo të huaja në Kosovë, në sektorin e promovimit, marketingut dhe tregtimit të produkteve dhe shërbimeve dhe te perdorimit te fondeve europiane. Do te konsiderohet titull preferencial përvoja e mëparshme prane në institucioneve dhe/ose shoqerive italiane;
- Njohuri të mira të sektorit ekonomik lokal të Kosovës, si dhe të rrjetit të bashkëbiseduesve institucionalë dhe privatë me interes për shoqëritë italiane;
- Kualifikimet profesionale konsiderohen kualifikime te preferueshme, nëse janë te rëndësishme;
- Përveç gjuhës shqipe te kete njohje te shkelqyer te gjuhës italiane. Njohja e mirë e gjuhës angleze konsiderohet si titull preferencial;
- Njohuri të mira të teknologjive të informacionit dhe sistemeve kryesore operative;
- Vendbanim në Kosovë te pakten ne dy vitet e fundit;
- Te mos kete dënime penale dhe te mos jete ne hetim në Kosovë, Itali dhe shtete të tjera.

2. Përshkrimi i detyrës

Pozicioni kërkon që Asistenti Analist i Tregut të kryejë, nën drejtimin e Drejtorit të ICE Tirane, përgjegjësi për Pikën e Korrespondencës në Prishtinë, detyrat kryesore të mëposhtme, edhe pse jo ekskluzive, në kuadër të promovimit të "Made in Italy" dhe te asistencës se marketingut për shoqëritë italiane të interesuara për të eksportuar dhe investuar në Kosovë, si dhe për shoqëritë e interesuara për projekte pune per ti filluar nëpërmjet përdorimit të fondeve europiane.

A. Asistenca per shoqërite:

- Analiza e tregut kosovar;
- Identifikimi dhe analiza e sektorëve më premtues për shoqëritë italiane;
- Përditësimi dhe përgatitja e postimeve/dergimeve për operatorë kosovarë dhe italianë;
- Hartimi i analizave të tregut dhe raporteve sektoriale për shoqëritë dhe shoqatat italiane;
- Identifikimi dhe përzgjedhja e palëve për shoqëritë italiane aktive në sektorë të ndryshëm produktesh;



ITALIAN TRADE AGENCY

- Zhvillimi i propozimeve të personalizuara të asistencës dhe kujdesi për aktivitetet përkatëse;
- Organizimi i eventeve promovuese si: panaiere, seminare, workshop, B2B, takime, kurse trajnimi, misione operatorësh/gazetarësh etj.;
- Analiza, monitorimi dhe shpërndarja e informacionit në lidhje me mundësitë tregtare, financimet kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare, tendera, etj.;
- Krijimi i përmbajtjeve për të përditësuar faqen web institucionale dhe mediat e ndryshme sociale (Twitter, Facebook, Instagram, etj.);
- Mbështetje për Analistët e Tregut dhe Drejtorin e Zyrës ICE përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit për institucionet italiane, në planifikimin e aktiviteteve promovuese dhe administrimin e kontakteve me administratat dhe shoqatat e biznesit.

B. Administrative

- Përditësimi i Database (shoqëri italiane dhe vendase);
- Regjistrimi i të dhënave administrative, arkivimi i dokumentave, faturimi i shërbimeve, etj;
- Përgatitja e dokumentave të kërkuara në marrëdhëniet me shoqëritë;
- Administrim kontabël / administrativ i iniciativave promovuese të kompetencës;
- Aktivitete sekretarie kur kërkohet;
- Mbështetje për zyrën ICE kompetente në lidhje me detyrat e tjera të caktuara siç duhet nga Drejtori.

Asistentit Analist i Tregut mund të kërkohet, që për shkak të detyrave që duhet të realizojë për përmbushjen e punës së tij, të shkojë në misione brenda dhe jashtë Kosovës.

3- Paraqitja e kërkesave për praninë

Kandidatët duhet të paraqesin kandidaturën e tyre duke përdorur **Formularin bashkëlidhur** këtij njoftimi. Ata duhet të dërgojnë një **Curriculum Vitae (CV) në formatin europian**, duke pasur kujdes në specifikimin e kualifikimeve dhe eksperiencave të fituara. CV-ja e redaktuar në gjuhën italiane duhet të shoqërohet me një kopje të titullit të studimit në posedim. Kandidatët duhet të prezantojnë gjithashtu një kopje të **dokumentit të identitetit** të vlefshëm dhe një certifikatë vendbanimi të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile me të cilën tregojnë vendbanimin e tyre, duke specifikuar se cilat janë shtetësitë që ata mbajnë. Gjithashtu, duhet të prezantojnë një certifikatë mbi dënimet penale dhe ndjekjet penale në proces që rezultojnë nga Sistemi i Evidences Penale SEP, dhe një certifikatë që nuk janë nën hetim të lëshuar nga Policia e Republikës së Kosovës.

Kandidatët që kanë shtetësi të tjera mund të paraqesin një vetëdeklarim me të cilin tregojnë vendbanimin e tyre fiskal dhe të vetëdeklarojnë mungesën e ndonjë dënimi penal ose ndjekje penale në proces e sipër.

Për shtetasit jo kosovarë kërkohet një kopje e lejes së qëndrimit dhe punës në Kosovë me një vlefshmëri

minimale prej një viti nga data e paraqitjes së kërkeses.

Kandidatet gjatë dërgimit të kandidaturës të tyre, duhet të specifikojnë me shkrim se autorizojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale të cilat do të përpunohen ekskluzivisht vetëm për qëllimet e procedurës së përzgjedhjes.

Dokumentacioni duhet të dërgohet ekskluzivisht me e-mail te Pika e Korrespondencës në Prishtinë në adresën e mëposhtme të postës elektronike: selezione.pdc.pristina@ice.it jo më vonë se ora 12.00 e datës 14 tetor 2024, duke vene ne objektin e e- mail qe do dergohet shënimin “**Selezione PdC Pristina**”.

4. Përjashtimi nga procedurat e përzgjedhjes

Percaktojnë përjashtimin nga procedura e përzgjedhjes:

- Aplikimet pa nënshkrim autografik dhe pa dokumentat bashkëlidhur të përmendura më lart;
- Aplikimet në të cilat nuk rezulton posedimi i të gjitha kriterëve të përcaktuara në pikën e mëparshme 1. *Kriteret, kualifikimet dhe eksperiencat për pranim;*
- Aplikimet e prezantuara pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij njoftimi;
- Aplikimet jo të plota ne respekt te përshkrimit te mësipërm në pikën 3 të këtij njoftimi.

5. Vlerësimi i kualifikimeve dhe intervista

Zyra ICE - Agjencia e Tiranës, duke u asistuar nga një Komision i brendshëm i përberë prej tre anëtarësh të emëruar posaçërisht, do të shqyrtojë kandidaturat e marra, duke pranuar vetëm ato që posedojnë kriteret e përmendura në pikën 1. *Kriteret, kualifikimet dhe eksperiencat për pranim* dhe do të vendosë listën e kandidateve të pranuar për të bërë intervistë.

Thirrja për testet e provimit që do jepet, të cilat planifikojmë t'i zhvillojmë në muajin nëntor 2024, do të dërgohet me e-mail në adresën postës elektronike të deklaruar nga kandidati në momentin e aplikimit, të paktën 15 ditë përpara datës në të cilën ato do të zhvillohen. Testet e provimit, të cilat do të zhvillohen në Selinë e PdC-së në Prishtinë, do të ndahen në një test me shkrim dhe një test me gojë/praktike. Kandidatët nuk kanë të drejtë të rimbursohen për shpenzimet që do të bëjnë për paraqitjen në teste.

Testi me shkrim do të ketë përkthime të shkurtra me shkrim, pa përdorimin e fjalorit, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas të artikujve ekonomikë që publikohen në shtypin vendas, nxjerrjen dhe përpunimin e të dhënave ekonomike dhe statistikore dhe simulimin e një përgjigjeje, në italisht, për një kërkesë informacioni nga një shoqëri italiane.

Testi i provimit me gojë do të zhvillohet me një intervistë, në gjuhën italiane dhe shqiptare, dhe synon të konstatojë përshtatshmërinë për të kryer funksionet e qenësishme të kualifikimit, me një bisedë në italisht për çështjet aktuale ekonomike në Kosovë dhe një përkthim të shkurtër gojor nga shqipja në italisht pa





ITALIAN TRADE AGENCY
përdorimin e fjalorit.

Testi praktik do të synojë konstatimin e njohurive për mjetet kryesore të informatikes (IT-së) dhe aplikacionet përkatëse.

Komisioni gjithashtu do të vlerësojë edhe cilësinë e titujve të studimit dhe kualifikimeve të marra (notat, lëndët, çdo kualifikim pasuniversitar), të përvojës profesionale (subjekti ku është kryer përvoja, lloji i veprimtarisë, referencat, kohëzgjatja etj.).

Testi me shkrim do të ketë një rezultat maksimal prej 30 pikësh. Testi me shkrim kalohet në bazë të arritjes së një rezultatit minimal prej 18/30. Testi me gojë/praktika do të ketë një rezultat maksimal prej 40 pikësh. Testi me gojë do të kalohet në bazë të arritjes së rezultatit minimal prej 18/30. Testi praktik do të kalohet në bazë të arritjes së rezultatit minimal prej 6/10 pikë. Vlerësimi të CV-ve, do të jepen maksimalja 30 pikë nga të cilat:

- për titujt e studimit do të jepen maksimumi 10 pikë;
- për përvojat e mëparshme të punës do të jepen maksimumi 20 pikë.

6. Lista përfundimtare

Lista do të formulohet nga Komisioni shqyrtues menjëherë pas përfundimit të fazës së provimit. Kandidatët që kanë marrë rezultatin minimal prej 60/100 do të konsiderohen të aftë për renditje në liste dhe nga ata do të përzgjidhet kandidati që do të grumbullojë rezultatin më të lartë në total.

Rezultati i arritur do të jepet me vendim unanim të Komisionit Vlerësues.

Drejtori i Zyrës ICE - Agjencia Tiranë, përgjegjës për Pikën e Korrespondencës në Prishtinë, pasi njëh rregullsinë e procedurës së përzgjedhjes, miraton listen për të vazhduar me aktet pasuese. Lista hyn në fuqi menjëherë dhe mund të përdoret për punësim me afat të caktuar/të pacaktuar pranë Pikës së Korrespondencës në Prishtinë gjatë periudhës së vlefshmërisë së listes, e cila është dy vjet nga data e aprovimit të saj. Rezultati i përzgjedhjes dhe regjistrimit në liste do të njoftohet kandidatëve nëpërmjet postes elektronike dhe do të publikohet në faqen e internetit të zyrës së ICE në Tiranë dhe në PdC në Prishtinë. Duhet theksuar se përzgjedhja nuk është garanci për dhënien e pozicionit të punës.

7. Krijimi i marrëdhënies së punës

Marrëdhënia e punës do të krijohet me lidhjen e kontratës me afat të pacaktuar, me kusht kalimin me sukses të periudhës 6-mujore të provës. Kontrata mund të lidhet vetëm pas marrjes së autorizimit për punësim nga ana e Ambasades Italiane në Prishtinë dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Shefi i Misionit. Nëse përfaqësia diplomatike, pasi të ketë kryer kontrollet e nevojshme, nuk lejon lëshimin e autorizimit për punësim, kontrata





ITALIAN TRADE AGENCY

nuk mund të lidhet dhe kandidati në fjalë nuk do të mund të jete pjese e stafit të Pikës së Korrespondencës në Prishtinë.

Kandidati qe rezultoi fitues duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm brenda 15 ditëve nga data e komunikimit të fitimit së pozicionit nga Agjencia ICE:

- Certifikatë mjekësore që vërteton që është i aftë për të kryer veprimtarinë e punës;
- Kopje e njehsuar me origjinalin e certifikuar nga noteri publik i titujve te studimit diplomave (përfshirë listen e notave), sipas Curriculum Vitae të nënshkruar siç duhet nga kandidati;
- Për shtetasit jo kosovarë, kopje e njehsuar me origjinalin e certifikuar nga noteri publik të lejes së qëndrimit dhe të punës në Kosovë.

Nëse nga kontrollet në vijim do të zbulohet pavërtetësia e përmbajtjes së vetëdeklarimeve, i interesuari do të përballlet me sanksionet penale të parashikuara në nenin 76 të Dekretit të sipërpërmendur të Presidentit. n. 445/2000, duke i hequr menjëherë punësimin dhe çdo përfitim tjetër të marrë në bazë të deklaramit të pavërtetë.

8. Përpunimi i të dhënave personale

Dorëzimi i aplikimeve për të marrë pjesë në për zgjedhjen nga kandidatët nënkupton dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave të tyre personale, përfshirë të dhënat sensitive, nga stafi i caktuar për ruajtjen e aplikimeve dhe për përdorimin e tyre për kryerjen e procedurave të konkurrimit.

Për këtë, ju kërkohet të citoni ne fund te CV shprehjen *“Unë autorizoj përpunimin e të dhënave të mia personale në bazë të Dekretit Legjislativ 196, datë 30 qershor 2003, nenit 13 GDPR dhe te Ligjit N. 06/L-082 Për mbrojtjen e të dhënave personale ”.*

9. Klauzola mbrojtëse

Zyra ICE – Agjencia Tirana rezervon të drejtën të revokojë këte shpallje për arsye serioze të përshtatshmërisë së vlerësuar në mënyrë diskrecionale. Gjithashtu rezervon të drejtën të mos vazhdojë me caktimin e detyrës për shkak të mungesës së kandidatëve që plotesojne kriteret e kërkuara dhe te mungesës së disponibilitetit te burimeve financiare për të mbuluar shpenzimet e emerimit.

10. Kodi i etikës dhe sjelljes

Kandidatët e suksesshëm duhet ti permbahen Kodit te Etikës dhe Sjelljes të Agjencisë ICE, i cili do te jete pjesë integruese e kontrates.

